***REPUBLIKA E KOSOVËS***
***KOMUNA DRENAS***
***Zyra e Kryetarit***
***Drenas***

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 24.04 | 2019 | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 - | 060 - | 21432 | |

***Data: 23.04.2019***

Në bazë të Vendimit nr. 12-030-786, të datës 04.01.2018 të Kuvendit Komunal, si dhe mbështetur në tubimet e deritanishme të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në emër të Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci, ju drejtoj këtë:

# F T E S Ë

Për anëtarin/en ____________________, nga ____________, që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), lidhur me zhvillimet e fundit në Komunën e Drenasit.

Mbledhja mbahet më datën 02.05.2019, me fillim në orën 14:00, në Sallën e Mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve.

## Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur më 11.03.2019;
2. Siguria në komunikacion, aksidentet dhe parkingjet në vendet e palejuara;
3. Të ndryshme.

**Kopje:** **Anëtarëve të KKSB-së**

**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
14.04 2019
Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera
01-060-21432

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)**
**IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

**Komuna / Opština:** Drenas **Data / Datum:** 02.05.2019

**Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini:** 3

**Takim i rregullt / Redovni sastanak** ☒ **Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak** ☐

**Numri i anëtarëve të KKSB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ:** 13

**A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSB-së?**
**Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?**

Po / Da ☐
Jo / Ne ☐
Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☒

**A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSB-së?**
**Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?**

Po / Da ☒ *OSCE dhe UNMIK.*
Jo / Ne ☐

*Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë*
*Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju*

**A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo Nënkryetari?**
**Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?**

Po / Da ☒
Jo / Ne ☐

**Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur më 11.03.2019;
2. Siguria në komunikacion, aksidentet dhe parkingjet në vendet e palejuara;
3. Të ndryshme.

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

**Konkluzionet / Zaključci:**

1. Mbledhjen e kryesoi kryetari Ramiz Lladrovci, i cili i përshëndeti të pranishmit, pastaj pyeti nëse dikush ka për të shtuar diçka sa i përket rendit të ditës, hodhi në votim rendin e ditës i cili u aprovua. Po ashtu edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa ndonjë vërejtje.

   Kryetari Lladrovci foli për shqetësimin e adresuar sa i përket parkimeve në vendet e ndaluara me shenja, në vendet e gjelbëruara, ndërsa drejtoresha e DSHPE-se Lumnije Krapi i njoftoi të pranishmit për punën e kësaj Drejtorie në vendosjen e shenjave dhe kërkoi ndihmën e policisë kundër dëmtuesve të tyre.

2. Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës konkluzionet e miratuara ishin si në vijim:
   U dakordua që Komuna bashkë me Stacionin Policor të Drenasit dhe të rinjtë të ndërmarrin një fushatë vetëdijesuese për sigurinë në komunikacion dhe ndaj parkimeve në vendet e palejuara dhe dëmtimet e vendeve të gjelbëruara si pasojë e këtyre parkimeve në vende të palejuara.

3. Për pikën të ndryshme përfaqësuesi nga Bashkësia Islame e Kosovës në Drenas kërkoi nga Policia e Drenasit që gjatë muajit të Ramazanit të shtojnë prezencën e tyre në Komoran, Zabel të Ultë dhe Tërstenik.

**Procesverbali aprovohet nga Kryetari:**
**Izveštaj odobrava Gradonačelnik:** **Ramiz Lladrovci** 03.05.2019
nënshkrimi / potpis

**Data e aprovimit / Datum odobravanja:**

***Rekomandimet:***

- *Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;*
- *Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;*
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën:* mpb.dsb@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën:* Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net
- *Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.*